



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E LARTË

Këshilli i Gjykatës

Nr. 27 Prot.

Tiranë, më 16 . 12 .2025

V E N D I M

Nr. 17 , datë 16 / 12 /2025

“PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 6, DATË 21.03.2024, “PËR CAKTIMIN E GJYQTARËVE NË PËRBËRJE TË KOLEGJEVE TË GJYKATËS SË LARTË SI DHE CAKTIMIN E GJYQTARËVE NË PËRBËRJE TË TRUPAVE GJYKUESE TË SECILIT KOLEGJ”

Në mbështetje të pikave 2 dhe 3 të nenit 23 si dhe të shkronjës “ç” të nenit 38 të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar);

Me rastin e emërimit të gjyqtarit Genti Shala në Gjykatën e Lartë, i cili zëvendësoi gjyqtarin Medi Bici në Kolegjin Penal;

Bazuar në mendimin e dhënë nga gjyqtarët e Kolegjit Penal për përbërjen e trupave gjykuese në këtë Kolegj;

Këshilli i Gjykatës së Lartë, në mbledhjen e datës 16.12.2025,

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 6, datë 21.03.2024 “Për caktimin e gjyqtarëve në përbërje të kolegjeve të Gjykatës së Lartë si dhe caktimin e gjyqtarëve në përbërje të trupave gjykuese të secilit kolegj”, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në Kolegjin Penal, **Trupi gjykues nr. 2** përbëhet nga gjyqtarët si më poshtë:

Trupi gjykues nr. 2

Ilir Panda

Albana Boksi

Genti Shala

2. Për çështjet gjyqësore në të cilat gjyqtari Medi Bici ishte në përbërje të trupit gjykues në cilësinë e anëtarit dhe që janë shpallur datat e shqyrtimit, të bëhet zëvendësimi i gjyqtarit Medi Bici me gjyqtarin Genti Shala. Çështjet e tjera gjyqësore në të cilat gjyqtari Medi Bici ishte në përbërje të trupit gjykues sipas procedurës së shortit manual, të rishortohen ndërmjet gjyqtarëve të tjerë të Kolegjit Penal përfshirë edhe gjyqtarin Genti Shala.
3. Ky vendim t'i komunikohet gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, Njesisë së Shërbimit Ligjor, Kancelarit si dhe të publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLI I GJYKATËS

ANËTAR

ILIR PANDA

ANËTAR

KELMENT GRECA

KRYETAR

SOKOL SADUSHI